

KIS Interpretimi 25

Tatimet mbi të Ardhurat—Ndryshimet në Statusin Tatimor të një Njësie Ekonomike ose Aksionerëve të saj

Referencat

- SNK 8 *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*
- SNK 12 *Tatimet mbi të Ardhurat*

Çështja

- 1 Një ndryshim në statusin tatimor të një njësie ekonomike ose të aksionerëve të saj mund të ketë pasoja për njësinë ekonomike duke rritur ose ulur detyrimet ose aktivet e saj tatimore. Kjo për shembull mund të ndodhë me listimin publik në bursë të instrumentave të kapitalit të vet të njësisë ekonomike ose me ristrukturimin e kapitalit të vet të njësisë ekonomike. Kjo gjithashtu mund të ndodhë me zhvendosjen e një aksioneri kontrollues në një shtet tjetër. Si rezultat i ngjarjeve të tilla, njësia ekonomike mund të tatohet ndryshe; ajo mundet për shembull të përfitojë ose humbasë lehtësi tatimore ose të bëhet subjekt i një pëqindje tatimore të ndryshme në të ardhmen.
- 2 Një ndryshim në statusin tatimor të një njësie ekonomike ose të aksionerëve të saj mund të ketë një efekt të menjëhershëm ndaj detyrimeve ose aktiveve tatimore aktuale të njësisë ekonomike. Ndryshimi gjithashtu mund të rrisë ose të ulë detyrimet dhe aktivet tatimore të shtyra të njohura nga njësia ekonomike, në varësi të efektit që ka ndryshimi i statusit tatimor në pasojat tatimore që krijohen nga rikuperimi ose shlyerja e vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të njësisë ekonomike.
- 3 Çështja është se si njësia ekonomike duhet të kontabilizojë pasojat tatimore të një ndryshimi në statusin e saj tatimor ose në atë të aksionerëve të saj.

Konsensusi

- 4 Ndryshimi në statusin tatimor të njësisë ekonomike ose të aksionerëve të saj nuk krijon rritje ose ulje në shumën e njohura drejtpërdrejt në kapitalin e vet. Pasojat tatimore aktuale dhe të shtyra të ndryshimit në statusin tatimor duhet të përfshihen në fitimin ose humbjen e periudhës, përveçse kur këto pasoja lidhen me transaksione dhe ngjarje që rezultojnë, në të njëjtën periudhë ose në një periudhë tjetër, në një kreditim ose kalim të drejtpërdrejtë në shumën e njohur të kapitalit të vet. Këto pasoja tatimore që lidhen me ndryshimet në shumën e njohur të kapitalit të vet, në të njëjtën ose periudha të ndryshme (të pa përfshira në fitimin ose humbjen), duhet të kalohen ose kreditohen drejtpërdrejt në kapitalin e vet.

Data e konsensusit

Gusht 1999

Data e hyrjes në fuqi

Ky konsensus hyri në fuqi në 15 korrik 2000. Ndryshimet në politikat kontabël do të kontabilizohen në përputhje me SNK 8.